



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2021:288160  
Datë: 15.11.2023  
Numri i dokumentit: 04925451

KPPP.nr. 994/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, “Bill Clinton”, p.nr., kundër debitorit “Drita”, me seli në Prishtinë, rr. “Xhavit Mitrovica”, duke vendosur sipas propozimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 3268/17, i lejuar me datë 28.12.2017, nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 13.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar propozimi i debitorit “Drita”, me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 3268/17, i lejuar me datë 28.12.2017, nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit ID.nr. 15635, ka lejuar urdhrin përmbartimor P.nr. 3268/17, të datës 28.12.2017, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej EUR 282.35 në emër të bartjes së miturinave, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, në propozimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se në propozim për përmbartim nuk është emërtuar debitori, nuk është treguar numri i biznesit mirëpo vetëm është shënuar emri “Drita”, andaj si i tillë propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet dhe është i mangët. Me tej ka shtuar se nuk ka

ndonjë kontratë për shërbime me kreditorit dhe se debitori nuk ka lokal afarist të regjistruar pranë organeve kompetente. Për këtë arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimin të debitorit, me Aktvendimin PPP.nr. 160/18, të datës 16.09.2018, ka refuzuar prapësimin e debitorit Drita të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 3268/17, të datës 28.12.2017.

Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë në gjykatën e shkallës së dytë. Ndërsa, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr. 4893/2019, të datës 16.10.2019, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit, ndërsa ka anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr. 160/2018, të datës 16.09.2018, dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim pranë gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata në ri-procedurë, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marr për bazë vërejtjet e gjykatës së shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje “LPP”), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Me nenin 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit. 2. Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbarrim kreditori nuk ka treguar të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht në propozim për përmbarrim është ushtruar ndaj “Drita” rr.

“Xhavit Mitorvica”, Prishtinë, duke mos treguar emrin e debitorit, numrin e biznesit të debitorit, apo të dhënat e tjera të debitorit. Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshkrimi i debitorit “Drita” rr. “Xhavit Mitorvica”, Prishtinë, pa treguar emrin e debitorit dhe numrin e biznesit, nuk është e mjaftueshme për identifikimin e saktë të debitorit. Ndërsa, kreditori nuk e ka plotësuar propozimin për përmbaram duke treguar numrin e biznesit të debitorit, as pas pranimit të Konkluzionit PPP.nr. 1652/19, të datës 12.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Andaj, si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbaram nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së.

Ndërsa, me dispozitën nga neni 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbaramit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbaram nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Nisur nga kjo dispozitë, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbaramit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbaram nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbaram përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së. Andaj, duke qenë se urdhri përmbaramor është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin përmbaramor.

Veç të metave në kuptim të nenit 38 të LPP-së, gjykata gjithashtu vlerëson se ekstrakti me shifër ID.nr. 15635 mbi bazën e së cilit është lejuar përmbaramor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që me propozimin për përmbaram kreditori ka kërkuar përmbushjen e borxhit në shumën prej EUR 282.35, për periudhën kohore prej 31.12.2013 deri më 30.10.2017, ndërsa nga shikimi i ekstraktit rezulton se një pjesë e borxhit të kërkuar për përmbushje është bartur nga periudhat paraprake për të cilat nuk është kërkuar përmbushja nga ana e kreditorit, ndërsa në ekstrakt nuk është pasqyruar periudha kohore për të cilën është krijuar pjesa e borxhit të bartur. Si rrjedhojë e kësaj, nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri te borxhi

kryesor, andaj ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe si i tillë nuk është i përshtatshëm për përmbarim.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 994/22, datë 13.11.2023

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.